



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /
GOVERNMENT OF KOSOVA



Ministria e Punëve të Brendshme
Ministarstvo Unutrašnjih Poslova
Ministry of Internal Affairs

DEPARTAMENTI I INSPEKTIMIT

Inspektorati Policor i Kosovës
Policijski Inspektorat Kosova
Police Inspectorate of Kosovo

Raport Inspektimi 04/2014

VLERËSIMI I MENAXHIMIT TË TRAFIKUT RRUGOR NGA POLICIA E KOSOVËS



2014

SHKURTESAT

MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
IPK	Inspektorati Policor i Kosovës
PK	Policia e Kosovës
DPP	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë
DKRR	Divizioni i Komunikacionit Rrugor
NJRKRR	Njësia Rajonale e Komunikacionit Rrugor
NJKA	Njësia për Kontroll të Autostradës
DRP	Drejtoria Rajonale e Policisë
PSO	Procedura Standarde e Operimit

P Ë R M B A J T J A

1. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

2. HYRJE

3. PËRMBLEDHJA E TË GJETURAVE

3.1. Organizimi dhe Struktura;

3.2. Vlerësimi i performancës policore në menaxhimin e trafikut rrugor;

3.3. Identifikimi dhe vlerësimi i shkaktarëve të aksidenteve rrugore;

3.4. Identifikimi dhe vlerësimi i shkallës së sigurisë në komunikacionin rrugor;

4. PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIMET

4.1. Përfundimet

4.2. Rekomandimet

1. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

1.1 IPK-ja sipas ligjit të saj, ka ndërmarr një inspektim në fushën e komunikacionit rrugor siç parashihet në nenin 25 pika 4.7 të ligjit të IPK-se, me temën “Vlerësimi i menaxhimit të trafikut rrugor nga Policia e Kosovës”. Me autorizim të Kryeshefit Ekzekutiv të IPK-së, ky inspektim është zhvilluar për të vlerësuar kryerjen e detyrave nga zyrtarët e Divizionit të Komunikacionit Rrugor, NJRKRR-ve dhe NJKA-së në menaxhimin e trafikut rrugor.

1.2 Inspektimit në këtë fushë i ka parapri faza hulumtuese e cila ka filluar me datë 20.02.2014, si dhe hartimi i programit inspektues përfshirë edhe përzgjedhjen e metodologjisë së punës. Programi i punës inspektuese ka paraparë fillimin e aktivitetit inspektues në terren prej datës 24 mars deri më 17 prill 2014.

1.3 Periudha e vlerësuar në këtë raport përfshin periudhën kalendarike dy vjeçare të punës, pra vitin 2012 dhe 2013, ku janë inspektuar DKRR, shtatë (7) NJRKRR-të si dhe NJKA.

1.4 Inspektimi i strukturave dhe funksioneve të Policisë së Kosovës bëhet për të siguruar llogaridhënie, efikasitet dhe efektivitet në implementimin e ligjeve të aplikueshme, akteve nënligjore dhe procedurave tjera standarde të veprimit në fuqi. Ky raport i inspektimit përfshinë të gjeturat dhe rekomandimet e dhëna për përmirësimin e gjendjes së gjetur.

1.5 Të gjeturat tregojnë se zyrtarët përgjegjës të kësaj fushe të inspektimit, kanë ndërmarrë një varg aktiviteteve si masa preventive, në uljen e numrit të aksidenteve si dhe në ngritjen e shkallës së sigurisë në trafikun rrugor. Aktivitetet e ndërmarra si masa preventive janë: hartimi i planeve operative, planeve të veprimit, organizimi i konferencave dhe tryezave të rrumbullakëta pastaj ligjërimit në shkolla rreth sigurisë në trafik etj.

1.6 Të gjeturat e inspektimit tregojnë se shkalla e sigurisë në komunikacionin rrugor gjatë vitit 2013 ka qenë më e mirë se në vitin 2012, ku edhe është arritur që në vitin 2013 të ulet numri i aksidenteve për 16.9% në krahasim me vitin 2012.

1.7 Gjithashtu të gjeturat tregojnë edhe për një mori mangësish të cilat kryesisht janë të natyrës së mungesës së personelit, mosfunksionalizimit të plotë të strukturës organizative, mospërputhje të të dhënave statistikore në mes të NJRKRR-ve dhe DKRR-së, zbrazëtirave në infrastrukturë ligjore si dhe mungesës së kushteve dhe pajisjeve të nevojshme për punë. Të gjitha të dhënat janë të paraqitura në mënyrë të detajuar në kapitullin “përmbledhe e të gjeturave”.

1.8 Lidhur me të gjeturat e paraqitura në këtë raport, IPK me datë 13.08.2014, ka mbajtur edhe takimin përmbysllës me menaxhmentin e PK-së të fushës përkatëse. Në këtë takim janë diskutuar të gjitha detajet e paraqitura në raport ku si konkluzion i këtij takimi ka dalë se të gjithë të pranishmit janë pajtuar me këto të gjetura dhe se nuk ka asnjë pikë e cila do të mundë të kontestohet.

1.9 Me datën 08.09.2014, IPK-ja ka pranuar nga Departamenti i Operacioneve, Planin e veprimit në realizimin e rekomandimeve, ku është dhënë zotimi i menaxhmentit të PK-së për implementimin e tyre. IPK do të përcjell implementimin e këtyre rekomandimeve konform këtij plani të veprimit.

2. HYRJE

2.1. Në bazë të Ligjit të Inspektoratit Policor të Kosovës Nr. 03/L-23, me autorizimin e Kryeshefit Ekzekutiv, Departamenti i Inspektimeve ka bërë Inspektim të rregulltë nga data 28 mars deri më 17 prill 2014 në Divizionin e Komunikacionit Rrugor dhe NJRKRR-të të PK-së.

2.2. Qëllimi i inspektimit është, vlerësimi i kryerjes së detyrave, në përputhje me legjislacionin në fuqi për sigurinë e komunikacionit rrugor në Republikën e Kosovës, nga personeli kompetent i angazhuar në Divizionin e Komunikacionit Rrugor, në DPP-Prishtinë dhe NJRKRR-të. Po ashtu përmes këtij inspektimi të ofrohen të dhëna analitike për nivelin e performancës së PK-së në sigurinë e komunikacionit rrugor si dhe të jepen rekomandime për përmirësimin e kryerjes së detyrave në këtë fushë të aktiviteteve policore.

2.3. Objektivat e inspektimit:

- Vlerësimi i performancës policore në menaxhimin e trafikut rrugor;
- Identifikimi dhe vlerësimi i shkaktarëve të aksidenteve rrugore;
- Identifikimi dhe vlerësimi i shkallës së sigurisë në komunikacionin rrugor;

2.4. Rëndësia e inspektimit qëndron në:

- ✓ Ngritjen e shkallës së përgjegjësisë dhe ngritjen e performancës së zyrtarëve policorë në menaxhimin e komunikacionin rrugor;
- ✓ Ngritjen e shkallës së sigurisë në komunikacionin rrugor;
- ✓ Zbritjen e numrit të aksidenteve në komunikacion;
- ✓ Identifikimin e shkaktarëve të aksidenteve;
- ✓ Ngritjen e besimit të qytetarëve tek Policia e Kosovës.

2.5. Metodologjia e punës e cila është aplikuar gjatë këtij inspektimi ka qenë një kombinim në mes të metodës së analizës të dokumentacioneve dhe të intervistimit. Analizimi dhe krahasimi i dokumenteve është bërë nga Raportet Vjetore të NJRKRR-ve, NJKA-së si dhe Raportet e Divizionit të Komunikacionit Rrugor.

Gjatë inspektimit në teren, janë zhvilluar intervista me trembëdhjetë (13) zyrtarë të lartë nga Divizioni i Komunikacionit Rrugor, shtatë (7) komandantët e NjKRR-ve dhe ai i NjKA-së, pesëdhjetë e dy (52) zyrtarë të tjerë të cilët janë të angazhuar me detyra në njësitë e komunikacionit rrugor dhe në NJKA. Gjithashtu janë intervistuar dhe zyrtarët policor të tetë (8) ekipeve patrulluese policore në pika të kontrollit që kanë qenë me detyra në kohën që kanë qenë të përcaktuar në orarin e inspektimit.

2.6. Si kriter matës Inspektorati Policor i Kosovës ka marrë:


- Ligjin e Policisë së Kosovës;
- Ligjin për Sigurinë në Komunikacionin Rrugor;
- Udhëzuesin për mënyrën e kryerjes së detyrave, mbikëqyrjen dhe rregullimin e komunikacionit rrugor;
- Procedura Standarde e Operimit/ Përshkrimi i vendeve të punës për personelin në Divizionin e Komunikacionit Rrugor, NJRKRR dhe NJKA-së;
- Doracaku i Parimeve dhe Procedurave të PK-së.

2.7 Periudha e mbulimit për këtë inspektim ka qenë, periudha kohore prej 01.01.2012 deri më 31.12.2013.

3. PËRMBLEDHJA E TË GJETURAVE

3.1. Organizimi dhe Struktura.

3.1.1. Struktura Organizative e Divizionit të Komunikacionit Rrugor është aprovuar më datë 20/05/2012 nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Republikës së Kosovës. Në bazë të strukturës organizative të PK-së, Divizioni i Komunikacionit Rrugor i takon Departamentit për Operacione dhe në kuadër të tij ka dy drejtori: Drejtoria për Siguri dhe Mbikëqyrje të Komunikacionit Rrugor dhe Drejtoria për Preventivë në Komunikacionin Rrugor. Drejtoria për Siguri dhe Mbikëqyrje të Komunikacionit Rrugor, në vete përmban dy sektore me nga dy njësi në secilin sektor dhe Drejtoria për Preventivë në Komunikacionin Rrugor, e cila në vete përmban dy sektor;, Sektori për Planifikim dhe Zhvillim që ka një njësi dhe një zyre ndërsa Sektori për Bashkëpunim dhe Përkrahje, në përbërjen e vetë ka dy zyre. Shih. strukturën organizative të DKRR-së.



3.1.2. Me themelimin dhe funksionalizimin e Drejtorisë Rajonale të Policisë për rajonin e veriut të Mitrovicës dhe lëshimin në përdorim të Autostradës “dr.Ibrahim Rugova” për menaxhimin e sigurisë në komunikacionin rrugor themelohen edhe dy njësi të reja dhe ato: NJRKRR/Mitrovicë-veri dhe NJKA. Përderisa NJRKRR/ Mitrovicë Veri i takon Drejtorisë Rajonale të Mitrovicës Veri, NJKA është në kuadër të Sektorit për Mbikëqyrje dhe Siguri të Komunikacionit Rrugor në Drejtorinë për Siguri dhe Mbikëqyrje të Komunikacionit Rrugor në Divizionin e Komunikacionit Rrugor. Këto njësi në kohën e aprovimit të Strukturës Organizative(20/05/2012) nuk ishin paraparë, por më vonë hartohen dhe aprovohen strukturat organizative edhe për këto dy njësi.

3.1.3. Gjatë inspektimit në Divizionin e Komunikacionit Rrugor, NJRKRR-ve, NJKA-së dhe zhvillimit të intervistave, IPK-ja ka vërejtur se Struktura Organizative e aprovuar më datë 20/05/2012 nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Republikës së Kosovës nuk është funksionalizuar në tërësi. Pra ende nuk janë të funksionalizuara disa njësi sipas kësaj strukture organizative si dhe vërehet mungesa e personelit për disa pozita. Në vazhdim në formë tabelare do të paraqesim gjendjen aktuale sa i përket funksionalizimit të strukturës organizative. Shih tabelën nr.1.

Tab.nr.1 Funksionalizimi i Strukturës Organizative të PK-së dhe gjendja aktuale në Div.Komunikacionit Rrugor, NJRKRR-ve dhe NJKA-së		
Subjekti	Funksionalizimi i Strukturës Organizative	Gjendja aktuale
Div.Komunikacionit Rrugor	JO	Nuk funksionojnë: Sektori për mbikëqyrje dhe siguri në komunikacionin rrugor, Njësia për mbikëqyrje të sigurisë në komunikacionin rrugor ,Njësia për planifikim dhe analizë dhe Zyra për bashkëpunim me institucionet në avancim të sigurisë rrugore.
Prizren	JO	Nuk funksionojnë: Ekipi për shërbime mbështetëse dhe zyra e tiketave(janë të angazhuar zyrtarë policor në vend të staf civil i cili mungon në NJRKRR).
Gjilan	PO	Mungojnë disa zyrtar nëpër zyre dhe ekipe, por funksionojnë.
Ferizaj	JO	Nuk funksionojnë: Ekipi për planifikim, zhvillim dhe evidentim; Ekipi për shërbime mbështetëse.
Prishtinë	JO	Nuk funksionojnë: Ekipi i Motoçikletave, Ekipi për planifikim, zhvillim dhe evidentim dhe Zyra e resurseve.
Mitrovicë-jug	JO	Nuk funksionon: Ekipi i Motoçikletave
Mitrovicë-veri	JO	Nuk funksionojnë: Ekipi i Motoçikletave, Ekipi për planifikim, zhvillim dhe evidentim, Zyra e resurseve dhe Ekipi për Shërbime mbështetëse.
Pejë	JO	Nuk funksionojnë: Ekipi për planifikim, zhvillim dhe evidentim; Zyra e resurseve dhe Ekipi i Motoçikletave.
NJKA	JO	Nuk funksionojnë: Ekipi i Motoçikletave, Sektori i resurseve, Zyra e tiketave, radiokomunikuesi. Ndërsa në ekipin për Personel dhe Administratë dhe Ekipin për Shërbime mbështetëse,punojnë zyrtar policor në vend të stafit civil të paraparë me Str.Organizative në këto dy ekipe.

3.1.4. Nga tabela e paraqitur më lartë vërehet qartë mosfunksionalizimi i plotë i strukturës organizative si dhe shpërndarja e personelit nuk është bërë konform strukturës organizative të miratuar. IPK-ja gjatë inspektimit ka vërejtur se në DKRR, NJRKRR dhe NJKA kishte mungesë të personelit të graduar e sidomos kishte mungesë të Rreshterëve. Gjithashtu është vërejtur se plotësimi i vendeve të punës për pozitat në të cilat sipas strukturës organizative parashihen që të jenë staf civil nuk ishin plotësuar konform strukturës, pasi që punët në këto pozita i kryenin zyrtarët policor (personeli i uniformuar). Duke pasqyruar parasysh gjendjen aktuale të personelit në Divizionin e Komunikacionit Rrugor, NJRKRR-ve dhe NJKA-së, IPK i rekomandon menaxhmentit të lartë të DKRR-së që në afatin sa më të shkurtër kohor të bëjë plotësimin e pozitave me personel konform strukturës organizative pasi që kjo ndikon drejtëpërsëdrejti në mbarëvajtjen e punës së tyre si dhe ngritjen e shkallës së sigurisë në Komunikacionin Rrugor.

3.1.5. Për kryerjen e aktiviteteve policore në Sigurinë e Komunikacionit Rrugor, Divizioni i Komunikacionit Rrugor, NJRKRR dhe NJKA mbështetën në Ligjin e Policisë së Kosovës, Ligjin për Siguri në Komunikacionin Rrugor, Udhëzuesin për mënyrën e kryerjes së detyrave në mbikëqyrjen dhe rregullimin e komunikacionit rrugor, Doracakun e Parimeve dhe Procedurave të PK-së dhe Procedura Standarde e Operimit/ Përshkrimi i vendeve të punës.

3.1.6. Gjatë inspektimit të NJRKRR-ve, inspektorët e IPK-së kanë hasur në PSO të pa aprovuara nga autoriteti miratues si p.sh në NJRKRR/Prishtinë, Pejë dhe Mitrovicë-jug. Po ashtu, IPK-ja gjeti se këto Procedurat Standarde të Operimit/ Përshkrimi i vendeve të punës (PSO) të NJRKRR-ve nuk kanë formë unike.

3.2. Vlerësimi i performancës policore në menaxhimin e trafikut rrugor

3.2.1. Divizioni i Komunikacionit Rrugor sipas strukturës organizative është pjesë e Departamentit për Operacione në DPP, fushë veprimtaria e sajë shtrihet në dy drejtime: në hartimin e politikave zhvillimore dhe mbikëqyrjen e zbatimit të tyre si dhe në sigurinë në komunikacionin rrugor.

3.2.2. Hartimi i politikave zhvillimore dhe mbikëqyrja e zbatimit të tyre bëhet në nivelin qendror, pra në DKRR, ku përveç hartimit të politikave kryhen edhe një mori aktiviteteve siç janë: Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet vendore, zhvillim, profesionalizëm, mbikëqyrje-inspektim, mbështetje administrative dhe logjistike, ruajtje e sigurisë në komunikacionin rrugor në Autostrada, përcjellja e personaliteteve të rëndësishme vendore dhe ndërkombëtare, përcjellja dhe kontrolli i transportit të materieve të rrezikshme në komunikacionin rrugor.

3.2.3. Kurse sa i përketë aktiviteteve në ruajtjen e sigurisë në komunikacionin rrugor në rrugët magjistrale, rajonale, lokale si dhe në mjediset urbane, DKRR i realizon nëpërmjet zinxhirit komandues të NJRKRR-ve dhe Stacionet Policore të cilat janë drejtpërdrejtë përgjegjëse për ruajtjen e sigurisë në komunikacionin rrugor, e ato gjinden drejtpërdrejtë në zinxhirin komandues të DRP-së.

3.2.4. Aktivitetet policore në Sigurinë e Komunikacionit Rrugor, NJRKRR-të i zhvillojnë në rrugët rajonale dhe magjistrale, ndërsa NJKA aktivitetet e saj e zhvillon në autostrada. Në rrugët urbane këto aktivitete në sigurinë e komunikacionit rrugor i zhvillojnë stacionet policore me përjashtim të rasteve të aksidenteve me lëndime të rënda, me fatalitet dhe dëme materiale të mëdha, që janë në kompetencë ekskluzive të NJRKRR-ve.

3.2.5. Përveç menaxhimit të aksidenteve, NJRKRR-të dhe NJKA zhvillojnë edhe një varg aktiviteteve si: koordinimi i punëve dhe mbështetje e stacioneve policore dhe njësisive tjera policore, bashkëpunimi dhe përkrahja e Inspektorateve qendrore dhe lokale si dhe bashkëpunimi me të gjitha institucionet vendore dhe ndërkombëtare që janë të lidhura me qështjen e sigurisë në komunikacionin rrugor, patrullimet në të gjitha rrugët magjistrale dhe rajonale të ndara sipas zonave të përgjegjësisë.

Në vazhdim do të paraqesim zonën e përgjegjësisë të shprehur në kilometra në rrugët rajonale dhe magjistrale, gjegjësisht autostradë ku zhvillojnë aktivitetet policore NJRKRR-të gjegjësisht NJKA (shih tab.nr.2)¹.

¹ Statistika nga Raportet vjetore të NJRKRR dhe NJKA.

Tab.nr.2. Mbikëqyrja e rrugëve nga NJRKRR-te dhe NJKA e shprehur në Km.						
	Rr. Rajonale	Rr. Magjistrale	Autostrada	totali	Nr. aktual i zyrtarëve policor në NJRKRR dhe NJKA	Aktivitetet për zyrtar policor në km
NJKRR/Prizren	291 Km	66 Km	-	357 Km	66	5.4 Km
NJKRR/Gjilan	174 Km	93 Km	-	267 Km	63	4.2 Km
NJKRR/Ferizaj	64 Km	166 Km	-	230 Km	63	3.6 Km
NJKRR/Prishtinë	179 Km	162 Km	-	341 Km	140	2.4 Km
NJKRR/Pejë	236 Km	143.5 Km	-	379.5 Km	85	4.4 Km
NJKRR/Mitrovicë-jug	144 Km	50 Km	-	194 Km	54	3.5 Km
NJKRR/Mitrovicë-Veri	39 Km	79 Km	-	118 Km	31	3.8 Km
NJKA	-	25 Km	79	104 Km	35	2.9 Km
totali	1127 Km	784.5 Km	79	2116.5 Km	537	3.9 Km

3.2.6. Nga të dhënat e paraqitura në tab. Nr.2, shihet se NJRKRR/ Pejë ka zonën e përgjegjesisë më të madhën 379.5 km, ndërsa zonën e përgjegjesisë më të vogël e ka NJKA me 104 km. Sa i përketë aktiviteteve policore në Sigurinë e Komunikacionit Rrugor për zyrtarët policor shprehur në kilometra prinë NJRKRR Prizren me 5.4 km për zyrtarë policor, ndërsa numrin më të vogël të kilometrave për aktivitete policore në sigurinë e komunikacionit rrugor për zyrtarët policor shprehur në kilometra ka NJRKRR/Prishtinë me 2.4 km.

3.2.7. Me qëllim të koordinimit të aktiviteteve si dhe ngritjes së shkallës së sigurisë në komunikacionin rrugor, NJRKRR-të si dhe NJKA konformë rregullave të parapara në PSO, kishin hartuar plane të punës për vitin vijues, statistika, raporte javore, mujore, vjetore dhe analiza për aktivitetet policore në sigurinë e komunikacionit rrugor. Duhet theksuar se NJRKRR-të dhe NJKA përveç planeve operative vetanake, pranojnë dhe realizojnë edhe plane operative nga Divizioni i Komunikacionit Rrugor dhe DRP. Shih tab.nr.3.²

Tab.nr.3, Planet operative dhe realizimi i tyre 2012/2013 nga NJRKRR-të dhe NJKA				
NJKRR	2012		2013	
	Nr.planeve operative	Realizimi i planeve (%)	Nr. i planeve operative	Realizimi i planeve (%)
NJKRR/Prizren	28	100%	27	100%
NJKRR/Gjilan	26	100%	33	100%
NJKRR/Ferizaj	44	100%	39	100%
NJKRR/Prishtinë	106	100%	46	100%
NJKRR/Pejë	56	100%	78	100%
NJKRR/Mitrovicë-jug	20	100%	23	100%
NJKRR/Mitrovicë-Veri	-	-	9	100%
NJKA	-	-	12	100%
Total	280	100%	267	100%

3.2.8. Nga të dhënat e paraqitura në tabelë, vërehet se Planet Operative gjatë vitit 2012/ 2013 janë realizuar të gjitha, mirëpo, vërehet një dallim në mes të NJRKRR-ve sa i përketë numrit të planeve operative të hartuara. Kështu që në vitin 2012 me hartimin e planeve operative prinë NJRKRR-Prishtinë (106), ndërsa në vitin 2013 prinë NJRKRR-Pejë (78). Vlenë të ceket se në tabelë për vitin 2012 mungojnë të dhënat për NJRKRR Mitrovicë-veri dhe NJKA për arsye se këto njësi nuk kanë funksionuar në vitin 2012.

² Raportet vjetore 2012/2013 të NJRKRR dhe NJKA, vlenë të ceket se në tab.nr.6 mungojnë të dhënat për vitin 2012 për NJRKRR-Mitrovicë/veri dhe NJKA për arsyeje se këto kanë filluar së vepruari në fund të vitit 2012.

3.2.9. Ndër aktivitetet tjera të NJRKRR-ve dhe NJKA-së, me qëllim të ngritjes së shkallës së sigurisë në komunikacionin rrugor padyshim se është edhe patrullimi dhe pikat e kontrollit nëpër rrugët e zonave të përgjegjësi të tyre. Gjatë patrullimeve dhe pikave të kontrollit shpeshherë zyrtarët policor hasin në vozites të cilët duke mos ju përshtatur rregullave të komunikacionit shkaktojnë kundërvajtje. Me qëllim të ngritjes së shkallës së sigurisë në komunikacion, të uljes së kundërvajtjeve në trafik si dhe me qëllim të vetëdijësimit të vozitësve, zyrtarët policor shpeshherë shqiptojnë edhe tiketa ndëshkuese. Në vazhdim do të paraqesim në formë tabelare të dhënat lidhur me shqiptimin e tiketave duke bërë edhe krahasimin e numrit të tiketave të shqiptuara për periudhën Janar-Dhjetor 2012-2013.³

Tab. nr.4. Tiketa të shqiptuara nga NJRKRR-të & NJKA Janar-Dhjetor 2012-2013						
NJRKRR & NJKA	Tiketa mandatore			Tiketa për Gjykatë		
	2012	2013	+/- %	2012	2013	+/- %
Prizren	26851	27027	+0.6	4076	4149	+1.7
Gjilan	21504	21392	-0.5	5584	5144	-7.8
Ferizaj	21581	23617	+9.4	3817	4112	+7.7
Prishtinë	39535	53089	+34.2	10183	10665	+4.7
Pejë	18470	23119	+25.1	6697	5591	-16.5
Mitrovicë/jug	13348	10903	-18.3	3477	2768	-20.3
Mitrovicë/veri	-	131	-	-	18	-
NJKA	1339	18953	-	397	5132	-
Total	142628	178231	+24.9	34231	37579	+9.7

3.2.10. Nga tabela e paraqitur më lartë vërehet qartë se gjatë vitit 2013 në krahasim me vitin 2012 kemi rritje të numrit të tiketave të shqiptuara si në kategorin e tiketave mandatore ashtu edhe në kategorinë e tiketave jo mandatore.

3.2.11. Përveq aktiviteve policore të cilat kanë për qëllim ngritjen e shkallës së sigurisë në komunikacionin rrugor, NJRKRR-të dhe NJKA aktivitet të tyre kanë edhe menaxhimin e aksidenteve të trafikut të cilat rezultojnë: me lëndime të rënda trupore, me fatalitet si dhe të aksidenteve me dëme të mëdha materiale. Pra, menaxhimi i këtyre llojeve të aksidenteve janë në kompetencë ekskluzive të këtyre njësive në të gjitha rrugët gjegjësisht autostradë. Në vazhdim do të paraqesim në formë tabelare aksidentet në komunikacionin rrugor të cilat janë menaxhuar nga NJRKRR-të dhe NJKA (shih tabelën nr.5)

³ Nga raportet 2012/13 të NJRKRR dhe NJKA.

Tab. nr.5. Aksidentet në komunikacionin rrugor të menaxhuara nga NJRKRR-te dhe NJKA për vitin 2012 / 2013 dhe krahasimi në %												
NJRKRR	Aksidente fatale			Aksi. me lëndime			Aksi. me dëme			Aksi. Godit e ik		
	2012	2013	+/- %	2012	2013	+/- %	2012	2013	+/- %	2012	2013	+/- %
Prizren	23	12	-47.8	894	556	-37.8	1353	700	-48.2	148	57	-61.4
Gjilan	19	10	-47.3	470	521	10.8	1187	1087	-8.4	0	0	0
Ferizaj	14	10	-28.5	292	255	-12.6	380	314	-17.3	11	21	90.9
Prishtinë	35	35	0	2042	1787	-12.4	1153	1777	54.1	115	-	-
Pejë	18	26	44.4	789	591	-25.0	1480	625	-57.7	113	95	-15.9
Mitrovicë/ Jug	11	6	-45.4	295	329	11.5	427	382	-10.5	22	16	-27.2
Mitrovicë/ Veri	-	3	-	-	21	-	-	40	-	-	2	-
NJKA	-	2	-	-	29	-	-	68	-	-	0	-
Totali	120	104	-13.3	4782	4089	-14.4	5980	4993	-16.5	409	191	-53.3

3.2.12. Nga të dhënat e paraqitura në tabelë, vërehet se numri i përgjithshëm i aksidenteve gjatë vitit 2013 ka psuar një rënje për 16.9% në krahasim me vitin 2012. Gjithashtu duhet theksuar se gjatë vitit 2013 kemi pas numër më të vogël të aksidenteve në të gjitha llojet e aksidenteve.

3.2.13. Gjatë inspektimit lidhur me aksidentet në komunikacion, Inspektorët kanë siguruar edhe të dhëna statistikore të cilat janë të përpiluara nga zyrtarët e DKRR-së. Vlenë të theksohet se gjatë analizimit të të dhënave statistikore të përpiluara nga DKRR si dhe duke i krahasuar këto të dhëna me të dhënat statistikore të përpiluara nga NJRKRR-të, Inspektorët kanë vërejtur se këto të dhëna nuk përputhen në mes vete.

3.2.14. Mospërputhje të të dhënave statistikore ka në të gjitha llojet apo kategoritë e aksidenteve. Përderisa në kategorinë e aksidenteve me dëme materiale deri diku mund të jetë e arsyeshme mospërputhja e të dhënave statistikore duke patur parasysh faktin se në statistikatat e paraqitura të DKRR-së janë të përfshira edhe aksidentet me dëme materiale të cilat kanë qenë në kompetencë dhe janë menaxhuar nga Stacionet Policore të Rendit (kategori kjo e cila nuk ka qenë në fokusin e inspektimit nga IPK), një mospërputhje e tillë është e pa justifikueshme tek të dhënat për aksidentet me fatalitet dhe tek aksidentet me lëndime trupore, pasi që këto dy kategori të aksidenteve janë në kompetencë ekskluzive të NJRKRR-ve gjegjësisht NJKA-së.

3.2.15. Pa dyshim se në ngritjen apo rënjen e performancës së zyrtarëve policor ndikojnë edhe kushtet e punës dhe pajisjet me të cilat ata punojnë. Sa i përket kushteve të punës duhet theksuar se në disa stacione policor nuk kanë hapsira të mjaftueshme për punë si dhe disa nga objektet janë të vjetërsuara, si psh. Objektet e NJRKRR-ve: Pejë, Prishtinë, Mitrovicë-veri dhe NJKA.

3.2.16. Gjithashtu gjatë inspektimit është vërejtur se personeli i NJRKRR-ve dhe NJKA-së ballafaqohet me mungesë të disa pajisjeve të nevojshme për punë siç janë: bateri për ndriçim, drita vezulluese për shënimin e vendit të ngjarjes, sprej florushqente për shënimin e dëshmimeve në vendin e ngjarjes, fletore për skicim me dorë në vendin ngjarjes, metër për matje në vend të ngjarjes, program të kompjuterit për skicimin e vendit të ngjarjes, kona me drita të natës, bateri për llaser, printer, aparat për kopje/fotokopje. Në vazhdim do të paraqesim në formë tabelare disa nga paisjet e domosdoshme për kryerje e aktiviteteve policore në sigurimin e komunikacionit rrugor dhe gjendjen e tyre në kohën e inspektimit.

Tab.nr.6. Gjendja aktuale e disa nga paisjet e domosdoshme në . Div.Komunikacionit Rrugor, NJRKRR dhe NJKA

Subjekti	Automjete funksional	Jo funksional	Radar funksional	Jo funksional	Alko-test funksional	Jo funksional	Kamera Digjitale funksionale	Jo funksional	Metra	GPS funksional	Jo funksional	Motoçikleta funksional	Jo funksional	Videokamera	Jo funksional	Laptop të instaluar në automjete	Kona	Gjenerator për ndriçim
	Div.Komunikacionit Rrugor	12	-	2	-	1		5	-	-	3	-	9	1	3	-	2	-
Prizren	7	6	10	9	9	2	5	5	5	7	5	4	2	-	-	-	55	-
Gjilan	7	3	9	15	11	3	9	3	24	10	-	1	-	-	-	-	20	1
Ferizaj	7	2	4	4	6	-	5	1	14	9	-	3	1	-	-	-	20	
Prishtinë	12	8	7	18	6	16	17	18	18	8	-	-	-	-	-	-	80	-
Mitrovicë -jug	8	7	9	4	4	3	26	10	8	14	4	-	-	-	-	-	8	
Mitrovicë -veri	5	-	4	-	2	-	1	-	-	4	-	-	-	-	-	-	-	-
Pejë	13	3	11	17	3	4	13	4	23	16	-	1	4				20	-
NJKA	6	2	3	4	2	-	2	-	6	1	-	-	-	-	-	-	12	
Totali	77	31	59	71	44	28	83	41	98	72	9	18	8	3	-	2	215	1

3.2.17. Nga të dhënat e paraqitura në tabelë ,shihet se nga paisjet e domosdoshme për kryerjen e aktiviteteve policore në Sigurinë e Komunikacionit Rrugor, një numër i madhë i tyre në NJRKRR dhe NJKA janë jashtë funksionit për shkaqe të ndryshme⁴.

3.2.18. Nga ajo që është thënë më lartë, vërehet se angazhimi i zyrtarëve policorë të NJRKRR-ve si dhe të NJKA-së gjatë vitit 2012 - 2013 në drejtim të ofrimit të sigurisë sa më të madhe në komunikacionin rrugor ka qenë mjaft i madhë. Në vazhdim do të paraqesim në formë tabelare angazhimet e zyrtarëve policor gjatë këtyre dy viteve. Në tabelë janë të paraqitura të dhënat e aktiviteteve policore të të gjitha NJRKRR-ve dhe NJKA-së, mirëpo këtu nuk janë të paraqitura të dhënat nga NJRKRR-Mitrovicë e Veriut pasi që kjo njësi është formuar në vitin 2013, si dhe të dhënat nga NJKA për vitin 2012 pasi që kjo njësi ka filluar të funksionoj në nëntor të vitit 2012.

⁴ Lista e pajisjeve në kohën e inspektimit të ofruara në DKRR,NJKRR dhe NJKA.

Tab.nr.7. Angazhimet e zyrtarëve policor nga NJRKRR-të dhe NJKA gjatë vitit 2012 – 2013 duke u bazuar në zonën e përgjegjesisë, numrin e aksidenteve dhe tiketat e shqiptuara.

NJRKRR	Nr. I zyrtarve		Km të përgjegjesisë		Km për zyrtar		tiketa				aksidente			
							Nr. I tiketave		Tiketave për zyrtar		Nr. I aksidenteve		Nr. I aksidenteve për zyrtar	
							2012	2013	2012	2013	2012	2013	2012	2013
viti	'12	'13	'12	'13	2012		2013		2012		2013			
Prizren	78	67	357	4.57	5.32	30927	397	31176	465	2418	31	1325	19.78	
Gjilan	61	62	267	4.37	4.30	27088	444	26536	428	1676	27.5	1618	26.1	
Ferizaj	54	54	230	4.25	4.25	25398	470	27729	514	697	12.9	600	11.11	
Prishtinë	122	136	341	2.80	2.50	49718	407	63754	469	3345	27.42	3599	26.46	
Pejë	91	82	379.5	4.17	4.62	25167	277	28710	350	2400	26.37	1337	16.3	
Mitrovicë -jug	72	57	194	2.69	3.4	16825	234	13671	240	755	10.48	733	12.86	
Mitrovicë -Veri	-	31	118		3.8	-	-	149	-	-	-	66	-	
NJKA	31	31	104	2.9	2.9	1736	56	24085	777	-	-	99	3.19	
totali	486	531	2116.5	4.35	3.98	176859	364	215810	406	11291	32.23	9377	17.65	

3.2.19. Nga tabela numër 7 vërehet se pothuajse në të gjitha NJRKRR-të gjatë vitit 2013 kemi pas numër më të vogël të zyrtarëve policor, me përjashtim të NJRKRR-Prishtinë ku kemi pas rritje të numrit të personelit. Sa i përket zonës së përgjegjesisë të cilën e mbulojnë (të shprehura në kilometra gjatësi për zyrtar), vërehet se zonën më të madhe të përgjegjesisë e ka NJRKRR Prizren me 5.32 Km për zyrtarë, kurse zonën më të vogël e ka NJRKRR-Prishtinë me 2.50 Km për zyrtarë. Gjithashtu vërehet se në të gjitha NJRKRR-të dhe në NJKA kemi pasë rritje të aktivitetit në shqiptimin e tiketave të trafikut, mirëpo kemi pasë ulje të aktiviteteve në menaxhimin e aksidenteve pasi që në këtë vit numri i aksidenteve të komunikacionit ka qenë më i vogël. Duhet theksuar se gjatë kalkulimeve të statistikave janë marrë për bazë numri i përgjithshëm i personelit të uniformuar të secilës njësi, duke përfshirë edhe menaxhmentin e tyre.

3.3. Identifikimi dhe vlerësimi i shkaktarëve të aksidenteve rrugore

3.3.1. Gjendja jo e mirë sa i përket sigurisë në komunikacionin rrugor si dhe numri i madhë i aksidenteve në rrugë sidomos të aksidenteve me fatalitet, doemos kërkon një analizë të mirëfillët të shkaktarëve të aksidenteve. Gjatë inspektimit Inspektorët e IPK-së kanë hasë në disa dokumente analizuese të aksidenteve në komunikacionin rrugor, të hartuara nga Divizioni i Komunikacionit Rrugor.

3.3.2. Analizat e aksidenteve në komunikacionin rrugor ishin hartuar në baza vjetore “Statistika dhe analizat e aksidenteve të komunikacionit rrugor 2013/2012” duke krahasuar gjendjen me periudhën e njëjt kohore të vitit paraprak. Përveç analizës vjetore të aksidenteve

kemi hasur edhe në analiza periodike të aksidenteve për periudha të caktuara kohore si “Analiza e aksidenteve në komunikacionin rrugor për periudhën kohore Janar-Maj 2013” si dhe “Analiza e aksidenteve fatale në Komunikacionin Rrugor Janar-Mars 2014”.

3.3.3. Gjatë analizimit të dokumentacionit të lartë përmendur është vërejtur se të gjitha këto dokumentacione analizuese, analizat e tyre i kanë bazuar në dy drejtime: në identifikimin e shkaktarëve më të shpeshtë të aksidenteve si dhe në identifikimin e faktorëve kontribues në aksidente. Ndër faktorët kontribues të aksidenteve mundë të përmendim, faktorin njeri (vozitës, këmbësor), faktorin kohë (shi, borë, akull), faktori rrugë (autostrada, magjistrale, rajonale, urbane, rrugë me zhavorr, rrugë me gropa etj.), ndërsa sa i përket shkaktarëve të aksidenteve mundë të përmendim: pakujdesinë e vozitësit, mos përshtatja e shpejtësisë me kushtet klimatike, tejkalimi i shpejtësisë, kyqja e pa sigurtë në rrugë, gjendja teknike e automjeteve etj.⁵

Në vazhdim do të paraqesim në mënyrë tabelare të dhënat statistikore të faktorëve kontribues në aksidentet e komunikacionit rrugor për periudhën kohore Janar-Dhjetor 2012-2013.

Tab.nr.8. Faktorët kontribues në aksidentet e komunikacionit rrugor Janar-Dhjetor 2012-2013		
Faktorët Kontribues	2012	2013
Faktori Njeri (shofer)	20549	19912
Faktori Njeri (këmbësor)	7	3
Gjendja teknike e automjetit	7	3
Infrastruktura rrugore si faktor	6	/
Faktoret Klimatik	179	3
Të tjerë (punime ne rrugë, kafshë ne rrugë)	6	5

3.3.4. Të dhënat statistikore të paraqitura në tabelë tregojnë se, si në vitin 2013 ashtu edhe në vitin 2012 shkaktarë më i shpeshtë i aksidenteve në komunikacionin rrugor, është faktori njeri(shofer). Nga analizimi i të dhënave statistikore vërehet se te aksidentet ku shkaktar është faktori njeri, rastet më të shpeshta të aksidenteve janë për shkak të manipulimit të pasigurtë me automjete, mos-mbajtja e distacës së mjaftueshme, mos-përshtatja e shpejtësisë ndaj kushteve të rrugës si dhe kyqja e pasigurtë në rrugë.

3.3.5. Një ndër faktorët e mundshëm për shkaktimin e aksidenteve në komunikacion është edhe gjendja teknike e automjeteve. Mirëpo, është e vështirë që të konstatohet se në një aksident shkaktarë ka qenë apo jo gjendja teknike e automjetit, pasi që automjetet e involvuara në aksidente rrallë herë dërgohen për ekzaminimin e gjendjes së tyre teknike. Duhet theksuar se automjetet nuk dërgohen për ekzaminimin e gjendjes teknike as në rastet e aksidenteve fatale.

3.4. Identifikimi dhe vlerësimi i shkallës së sigurisë në komunikacionin rrugor.

3.4.1. Fusha e sigurisë në komunikacionin rrugor, është problematikë komplekse ku kërkon implikimin e shumë institucioneve. Pra, këtu kanë ndikim të drejtëpërdrejtë Ministria e Infrastrukturës, Komunitat dhe Policia e Kosovës.

3.4.2. Gjatë inspektimit, Inspektorët kanë hasë në disa raporte analitike të cilat janë përpiluar nga PK-ja gjegjësisht nga DKRR-ja. Raportet analitike janë të përpiluara në baza vjetore si dhe

⁵ Raporti “Statistikat dhe Analizat e Aksidenteve të Komunikacionit Rrugor 2013/2012” Divizioni i Komunikacionit rrugor

raporte periodike të vlerësimit të gjendjes së sigurisë si: "Statistikat dhe analizat e aksidenteve të komunikacionit rrugor 2013/2012", "Analiza e aksidenteve në komunikacionin rrugor për periudhën kohore Janar - Maj 2013" dhe "Analiza e aksidenteve fatale në komunikacionin rrugor Janar - Mars 2014". Përveq këtyre raporteve analitike inspektorët kanë has edhe në raporte analitike të cilat i adresohen vetëm një segmenti të caktuar të rrugës si: "Vlerësimi i sigurisë rrugore në segmentin rrugor Veternik - QMI" dhe "Vlerësimi i sigurisë rrugore për segmentin rrugor Prishtinë - Milloshevë".

3.4.3. Inspektorët kanë vërejtur se gjatë përpilimit të raporteve analitike janë shqyrtuar shumë faktor të cilët kanë ndikuar në shkaktimin e aksidenteve. Gjithashtu është bërë analizimi i shumë rrethanave në të cilat kanë ndodhë aksidentet si: grupmoshat e vozitësve, koha e aksidenteve, gjendja e rrugës, mosha e viktimave etj.

3.4.4. Duke u bazuar në të dhënat statistikore me të cilat dispononë IPK sa i përket gjendjes së sigurisë në komunikacion, për pjesën e përgjegjësisë së NJRKRR-ve dhe NJKA-së, mund të themi se në vitin 2013 krahasuar me vitin 2012 siguria në komunikacion ka qenë diç më e mirë, pasi që kemi pas numër më të vogël të aksidenteve në të gjitha llojet e aksidenteve. Megjithatë, kjo gjendje e sigurisë nuk është në nivelin e kënaqshëm dhe se duhet të bëhen përpjekje që numri i aksidenteve të zvogëlohet sa më shumë.

3.4.5. IPK-ja gjeti se DKRR dhe NJRKRR-të kishin identifikuar dhe vlerësuar shkallën e sigurisë në komunikacionin rrugor. Divizioni i Komunikacionit Rrugor dhe NJRKRR-të kishin raporte për inspektimet e rrugëve dhe gjendjes në terren, kishin identifikuar vendet më të rrezikshme apo pikat e zeza, identifikime për mungesa të sinjalizimeve, shenjave të komunikacionit, shenjave tjera orientuese dhe ç'ështëje tjera që ndërlidhen me sigurinë në komunikacionin rrugor. Identifikimi dhe vlerësimi i të gjeturave nga inspektimet në terren të rrugëve të kryera nga DKRR dhe NJRKRR-të, ishin të paraqitura në formë të raporteve të ilustruara me fotografi nga vendet përkatëse. Po ashtu në këto raporte ishin propozimet apo rekomandimet institucioneve lokale dhe atyre qendrore, për vendet ku mendohej të intervenohej qoftë për të sanuarë gjendjen apo për të vendosur shenja të reja si p.sh. gur mbrojtës, udhërrëfyes etj.

3.4.6. Vlenë të ceket se, gjatë inspektimit, intervistave të zhvilluara dhe dokumentacionit të prezantuar nga Divizioni i Komunikacionit Rrugor dhe NJRKRR-të, IPK-ja gjeti se për përmirësimin e gjendjes në komunikacionin rrugor përveç aktiviteteve policore nevojitet edhe një angazhim gjithëpërfshirës i të gjitha institucioneve relevante atyre lokale dhe qendrore në çështjen e sigurisë së komunikacionit rrugor, e sidomos në çështjen e përmirësimit të infrastrukturës rrugore, vendosjen e sinjalizimeve dhe mirëmbajtja e tyre.

3.4.7. Identifikimi dhe vlerësimi i shkallës së sigurisë në komunikacionin rrugor, vlerësohet nga IPK-ja sepse ky veprim i PK-së i shërben që në mënyrë efektive dhe efikase t'i adresojnë sfidat kryesore të cilat vështirsojnë ofrimin e qëndrueshëm të sigurisë në komunikacionin rrugor, në përputhje me përgjegjësit që kanë DKRR, NJRKRR-të dhe NJKA.

4. PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIMET

4.1. Përfundimet

4.1.1. DKRR dhe NJRKRR-të kanë strukturë organizative të aprovuar më 20/05/2012 nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Republikës së Kosovës. Mirëpo, gjendja aktuale në DKRR dhe NJRKRR-te dhe strukturës organizative të lartëcekur është në mos përputhshmëri. Gjendja aktuale në DKRR tregon se nuk janë funksionale: sektor, zyre dhe njësi të cilat janë të parapara me strukturë. Gjendje e njejtë mbretëron edhe në NJRKRR-të ku nuk funksionojnë ekipe dhe zyre. Mos funksionalizimi i strukturës vërehet edhe te shpërndarja e personelit, duke filluar prej personelit me grada, stafit civil dhe numrit në total në Divizionin e Komunikacionit Rrugor, NJRKRR dhe NJKA, gjendja aktuale nuk është në përputhshmëri me Strukturën Organizative. Mos funksionalizimi i strukturës organizative me përpikëri është i dëmshëm dhe mund të ndikojë në performancën e aktiviteteve policore në Sigurinë e Komunikacionit Rrugor, në imazhin e PK-së tek qytetarët e Republikës së Kosovës.

4.1.2. DKRR dhe NJRKRR-të gjatë kryerjes së aktiviteteve policore në sigurin e komunikacionit rrugor, mbështeten në Ligjin e Policisë së Kosovës, Ligjin për Sigurinë në Komunikacionin Rrugor, Udhëzuesin për Mënyrën e kryerjes së detyrave në mbikëqyrjen dhe rregullimin e komunikacionit rrugor, Doracakut i Parimeve dhe Procedurave të PK-së dhe Procedura Standarde e Operimit/ Përshkrimi i vendeve të punës për personelin në Divizionin e Komunikacionit Rrugor dhe NJRKRR. Mirëpo, gjatë inspektimit është vërejtur Procedurat Standarde të Operimit (PSO) të NJRKRR nuk kanë formë unike dhe PSO e NJRKRR/Prishtinës, Pejës dhe Mitrovicë/jug nuk janë të miratuara nga autoriteti miratues.

4.1.3. Aktivitetet policore të ndërmarra gjatë një viti kalendarik, pasqyrohen në raport vjetor të punës. Në kuadër të DKRR-së është e përpiluar "Përmbledhje e aktiviteteve të Divizionit të Komunikacionit Rrugor për periudhën Janar-Dhjetor", kurse në kuadër të NJRKRR-ve dhe NJKA-së janë përpiluar raportet vjetore lidhur me të gjitha aktivitetet e ndërmarra duke përfshirë edhe të dhënat statistikore lidhur me aksidentet në komunikacionin rrugor. NJRKRR-të dhe NJKA, të dhënat statistikore i dërgojnë në DKRR ku edhe bëhet grumbullimi i tyre në një raport të përbashkët i cili përpilohet nga DKRR-ja. Gjatë analizimit të të dhënave statistikore është vënë në pah se të dhënat statistikore për aksidentet të paraqitura nga NJRKRR-të dhe NJKA nuk përputhen me të dhënat e paraqitura nga DKRR-ja.

4.1.4. Në kryerjen e detyrave policore rolë të rëndësishëm luajnë kushtet dhe pajisjet e punës. Gjatë inspektimit është vërejtur se disa nga NJRKRR-të dhe NJKA, aktivitetet e tyre i ushtrojnë në kushte jo të kënaqshme të punës, pasi që ballafaqohen me mungesën e hapsirës së mjaftueshme për punë. Gjithashtu është vërejtur se zyrtarët policor të NJRKRR-ve ballafaqohen edhe me mungesën e disa pajisjeve të nevojshme për punë, pasi që edhe një pjesë e pajisjeve ekzistuese ishin jashtë funksionit për shkak të defekteve të ndryshme.

4.1.5. Analizat e statistikave lidhur me aksidentet në komunikacionin rrugor, tregojnë se në vitin 2013, kemi pas një rënje të lehtë të aksidenteve në krahasim me vitin 2012. Megjithatë kjo gjendje nuk mund të jetë e kënaqshme kur kemi parasysh se ende kemi një numër të madh të aksidenteve të të gjitha llojeve, ku më shqetësuese është nëse kemi parasysh numrin e madh të aksidenteve me fatalitet. DKRR ka bërë disa analiza qoftë vjetore apo edhe periodike lidhur me identifikimin e shkaktarëve të mundshëm të aksidenteve në komunikacion.

4.1.6. Nga këto analiza shihet se ndër shkaktarët më të shpeshtë të aksidenteve është faktori njeri, gjë që tregon nevojën e shtimit të aktiviteteve policore në rrugë, qoftë përmes patrullimeve më të shpeshta apo edhe të organizimit më të shpeshtë të pikave të kontrollit. Duhet theksuar se PK-ja gjegjësisht DKRR-ja, NJRKRR-të dhe NJKA gjatë vitit 2012/2013 kanë përpiluar një numër të konsiderueshëm të planeve të veprimit dhe planeve operative me qëllim të preventivës apo parandalimit të aksidenteve në komunikacionin rrugor.

4.1.7. DKRR, NJRKRR-të dhe NJKA kanë plane të punës për vitin vijues, urdhëra operative, plane operative, orar ditor, javor, mujor ,orarin ditor të punës, raporte të patrullës ditore, statistika, raporte javore, mujore dhe vjetore, analiza.

4.1.8. Përkundër angazhimeve policore, në shtimin e masave pro-aktive në drejtim të ngritjes së sigurisë në komunikacionin rrugor, gjendja në bazë të dhënave vazhdon të mbetet jo e dëshirueshme, meqë të dhënat tregojnë se në nivel vendi në periudhën Janar-Dhjetor 2013, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak kemi ngritje të numrit të përgjithshëm të aksidenteve për 190 apo 0.96%.

4.1.9. IPK-ja, inkurajon dhe nxitë menaxhmentin e DKRR-së dhe NJRKRR-ve të secilit nivel, të vazhdojnë me angazhime dhe përkushtim të shtuar drejtë ngritjes së vazhdueshme të performancës, duke pasur për bazë rëndësin që bartin mbi vete në sigurinë e komunikacionit rrugor.

4.2. Rekomandimet

1. *IPK i rekomandon Menaxhmentit të lartë të DKRR-së, që në afatin sa më të shkurtër kohor të bëjë plotësimin e pozitive me personel konformë strukturës organizative, pasi që kjo ndikon drejtpërsëdrejti në mbarëvajtjen e punës së tyre si dhe ngritjen e shkallës së sigurisë në Komunikacionin Rrugor.*
2. *IPK, rekomandon menaxhmentin e lartë, konkretisht Drejtorin e Divizionit të Komunikacionit Rrugor, Drejtorët e Drejtorive Rajonale të PK-së, Komandantët e NJRKRR-ve, dhe NJKA-së që të veprojnë në harmoni me P-10.04 dhe që PSO-të të jenë të unifikuara.*
3. *IPK, rekomandon menaxhmentin e lartë të DKRR-së dhe NJRKRR-ve që t'i kushtojnë një rëndësi më të veçantë paraqitjes së të dhënave statistikore, në mënyrë që të shmangen mospërputhjet e të dhënave në mes të DKRR-së dhe NJRKRR-ve*
4. *IPK, rekomandon Menaxhmentin e lartë të PK-së, që të angazhohet në sigurimin e hapësirave të mjaftueshme për punë si dhe në furnizimin dhe funksionalizimin e pajisjeve të nevojshme për personelin, pasi që në këtë mënyrë do të sigurohet një performancë më e lartë e tyre.*
5. *IPK, rekomandon menaxhmentin e NJRKRR-ve dhe NJKA-së që të shtojnë masat preventive në parandalimin e aksidenteve në komunikacion rrugor, duke shtuar prezencën më të shpeshtë të tyre, përmes patrullimeve dhe pikave të kontrollit.*

**PLANI I VEPRIMIT PËR PËRMBUSHJËN E REKOMADIMEVE
“Vlerësimi i Menaxhimit të Trafikut Rrugor nga Policia e Kosovës”**

Nr.	Rekomandimi	Prioritet	Komentet	Plani i veprimit
1	IPK i rekomandon Menaxhmentit të lartë të DKRR-së, që në afatin sa më të shkurtër kohor të bëjë plotësimin e pozitive me personel konformë strukturës organizative, pasi që kjo ndikon drejtpërsëdrejti në mbarëvajtjen e punës së tyre si dhe ngritjen e shkallës së sigurisë në Komunikacionin Rrugor.	<i>I tërë rekomandimi</i>		<i>Muaji Tetor</i>
2	IPK, rekomandon menaxhmentin e lartë, konkretisht Drejtorin e Divizionit të Komunikacionit Rrugor, Drejtorët e Drejtorive Rajonale të PK-së, Komandantët e NJRKRR-ve, dhe NJKA-së që të veprojnë në harmoni me P-10.04 dhe që PSO-të të jenë të unifikuara.	<i>I tërë rekomandimi</i>		<i>Muaji Shtator</i>
3	IPK, rekomandon menaxhmentin e lartë të DKRR-së dhe NJRKRR-ve që t'i kushtojnë një rëndësi më të veçantë paraqitjes së të dhënave statistikore, në mënyrë që të shmangen mospërputhjet e të dhënave në mes të DKRR-së dhe NJRKRR-ve.	<i>I tërë rekomandimi</i>		<i>Muaji Shtator</i>
4	IPK, rekomandon Menaxhmentin e lartë të PK-së, që të angazhohet në sigurimin e hapësirave të mjaftueshme për punë si dhe në furnizimin dhe funksionalizimin e pajisjeve të nevojshme për personelin, pasi që në këtë mënyrë do të sigurohet një performançë më e lartë e tyre.	<i>I tërë rekomandimi</i>		<i>Veshtir i realizueshem . Viti 2015</i>
5	IPK, rekomandon menaxhmentin e NJRKRR-ve dhe NJKA-së që të shtojnë masat preventive në parandalimin e aksidenteve në komunikacion rrugor, duke shtuar prezencën më të shpeshtë të tyre, përmes patrullimeve dhe pikave të kontrollit.	<i>I tërë rekomandimi</i>		<i>Muaji Shtator</i>